



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.512/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Anita Peci, duke vendosur përkritazi me ankesat e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Rahovec, Sherif Bytyqi nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Rahovec, për shkak të manipulimit të votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 25.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHEN si të palejuara ankesat: ZL.A.nr.512/2017, ZL.A.nr.513/2017, dhe ZL.Anr.514/2017, të kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Rahovec, Sherif Bytyqi nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Rahovec, për shkak të manipulimit të votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

A r s y e t i m

Me datën 25.10.2017, PZAP-i ka pranuar 3 (tri) ankesa nga Sherif Bytyqi, kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal të Rahovecit, nga radhët e subjektit politik LVV, me të cilat pretendon se ka pasur manipulime me vota në vendvotimet: 1611A/01A, 1624A/02A, 1624A/03D, 1624A/01A, 1632A/02D.

Paneli, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar ankesat e lartcekura dhe i trajton si një ankesë evidentuar me ZL.Anr.512/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve, dhe për të tri ankesat vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës .

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë e ankesave, gjeti se:

Ankesat janë të pa lejuara

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar, në ankesat e parashtruara përkritazi me manipulimin e votave në vendvotimet e cekura në ankesa, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, nga shkelësi i supozuar, duhet të parashtrohen pas shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi, mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj paneli vendosi që ti hudh si të parakohshme ankesat e ankuesit. Hudhja e ankesave të ankuesit Sherif Bytyqi, nuk e paragjykon çështjen dhe atij nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesë tjetër, pas shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
ZL. Anr.512/2017 me datën 25.10.2017.



Kryesuesi i Panelit
Gyltene Sylejmani

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*